



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

Numri i lëndës: 2024:002408

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06328993

PPP.nr. 173/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike përmbareme të kreditores N. D. nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi avokat me seli në Gjakovë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Qendresa Bytyqi Hoxha, zyrtare ligjore, sipas dokumentit përmbareme për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbaremit kundër Urdhrit për lejimin e Përmbaremit numër P.nr.2009/24, të datës 03.07.2024, të lejuar nga Përmbareusi Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 21.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **APROVOHET** pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbareusit Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan, me numër P.nr.2009/24, të datës 03.07.2024, sa i përket kërkesës së kreditores që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbareme, debitori t’ia paguajë shumën prej 28.08 euro, në emër të TVSH-së prej 18%.
- II. **MBETET NË FUQI** Urdhri i Përmbareusit Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan me numër P.nr.2009/24, të datës 03.07.2024, për pjesën me të cilin është caktuar përmbaremi në bazë të dokumentit përmbareme, lidhur me pagesën në emër të borxhit kryesor në shumën prej 1.506,25 euro, me kamatë ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 05.12.2023 e deri në pagesën definitive, në emër të shpenzimeve të procedurës

Kontestimore shumën prej 124.00 euro si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës përbarimore në shumën prej 184,08 euro.

- III. Obligohet debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ja paguaj kreditores shumën prej 156,00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij Aktvendimi, nën kërcënim të përbarimit.

### A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan duke vepruar sipas propozimit të kreditores N. D. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat me seli në Gjakovë, ka lëshuar urdhër me numër P.nr.2009/24, i datës 03.07.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.2192/23, i datës 03.05.2024 i plotfuqishëm me datë 23.05.2024.

Konform aktgjykimit të lartcekur, të Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.2192/23, i datës 03.05.2024 kreditori ka parashtruar propozim për përbarim. Me propozimin për përbarim ka kërkuar që të caktohet përbarimi ashtu që të detyrohet debitori Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që kreditorit t'ia paguaj borxhin kryesor shumën prej 1.506,25€, në emër të shpenzimeve procedurës kontestimore shumën prej 124.00 €, si dhe shumën prej 184,08 € në emër të shpenzimeve përbarimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit. Në prapësim debitori ka theksuar se e kundërshton në tërësi propozimin për përbarim si dhe urdhrin për përbarim si tërësisht i pa bazuar. Gjithashtu, e kundërshton edhe pjesën e propozimit mbi shpenzimet e procedurës përbarimore, ku kreditorja ka kërkuar edhe 18 % të TVSH-së, për shkak se kërkesat lidhur me këto shpenzimet janë në kundërshtim me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve. Në fund i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin për përbarim ta shfuqizon, gjegjësisht ta hedh poshtë si të pabazuar.

Kreditorja, përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke i propozuar gjykatës që ta refuzoi si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe ta aprovoj si të bazuar Urdhrin Përbarimor të lëshuar nga Përbaruesi Privat dhe ta obligoi debitorin që kreditorit të ja paguaj

shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, në shumë prej 184.08 €. Ndërsa sa i përket shpenzimeve në emër të TVSH-së prej 18%, i njëjti ka theksuar se ajo është bazuar në Ligjin për Tatim në Vlerën e Shtuar Nr. 05/L-037, andaj pretendime e debitorit lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të procedurës përmbarimore janë të pa bazuara.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe ato të kreditores në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar urdhrin pjesërisht Urdhrin e Përmbaresit Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan me numër P.nr.2009/24, të datës 03.07.2024, sa i përket kërkesës së kreditores që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbarim debitori t'ia paguajë shtesën e shumës prej 28.08 euro në emër të TVSH-së prej 18%, me arsyetimin se këto shpenzime nuk i përkasin dispozitivit të vendimit gjyqësor me të cilin është paraqitur propozimi për përmbarim, e as nuk janë të parapara në Tarifën e Odës së Avokatëve Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitivit të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr. 173/24, me 21 Tetor 2024

G j y q t a r j a

Blerina KURTAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.